



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT
PËR VITIN 2024-2026

Dëgjimi i tretë buxhetor
PROCESVERBAL

I mbajtur në dëgjimin e tretë buxhetor me datën 15.08.2023 në sallën e kuvendit të komunës në ndërtesën e administratës komunale, duke filluar në orën 11:10. Takimin e kryesoi znj. Vjollca Qestaj, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa.

Takimin e III-të buxhetor e hapi znj. Vjollca Qestaj, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa anëtare Grupit Punues i formuar me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu.

Ky takim- dëgjim Buxhetor është i orientuar për të gjithë qytetarët e komunës së Junikut. Në këtë rast falënderim i veçantë për Have Lajqi përfaqësuese e OSBE.

Pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje znj. Vjollca Qestaj, theksoj se Qarkorja e parë buxhetore e nisur për Komunitat nga Ministria e Financave është pranuar me 15.05.2023, me qarkoren e parë buxhetore janë pranuar kufijtë fillestar mbi Grantet qeveritare, ku sipas qarkores 2024/01 buxheti i përgjithshëm për 2024 është 2,199,836.00 , nga këto burime financimi:

- Granti i përgjithshëm 1,103,827.00
- Granti specifik për arsim 544,726.00
- Granti specifik për shëndetësi 343,227.00, dhe
- Të hyrat vetanake 208,056.00 .

më tutje theksoi se pas dorëzimit të KAB-it në ministrinë e Financave, në muajin Gusht 2023 lëshohet Qarkorja e dytë buxhetore e cila i përcakton kategoritë shpenzuese dhe në bazë të së cilës duhet që të hartohet projekt buxheti 2024/2026 dhe të aprovohet deri me 30 shtator. Me pranimin e qarkores janë bërë të ditur kufijtë final në kategoritë ekonomike. Ku sipas qarkores 2024/02, Kategoria ekonomike paga dhe mëditje për Komunitat e Junikut për vitin 2024 është parashikuar të jetë 1,445,893.00€, kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime në vlerë 246,660.00€, kategoria ekonomike Shpenzime komunale në vlerë 38,500.00€, Kategoria Subvencioneve dhe transfereve në vlerë prej 62,000.00€, shpenzimet kapitale për në vlerë prej 406,784.00€.

Totali i buxhetit për komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/02 është parashikuar të jetë 2,199,836.00€.

Më tutje shpjegoi hapat e hartimit të Projekt Buxhetit Komunal duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së takimeve dhe dëgjimeve buxhetore deri te hartimi i KAB-it dhe projekt buxhetit.

Gjithashtu tha se edhe pse dihet se si komunë e vogël edhe mundësitë buxhetore janë të kufizuara, por prapë se prapë projekt propozimet merren parasysh dhe vendosen në strategji komunale.

Dhe nga kjo gjatë hartimit të buxhetit fillimisht planifikohen buxheti i shpenzimeve operative pastaj pjesa tjetër planifikohet për investime kapitale ku përafërsisht planifikohet diku rreth 350,000.00 - 400,000.00 € për kategorinë e investime kapitale për vitin 2024.

Më tutje tha se grupi punues i formuar sipas kërkesave ligjore për hartimin e buxhetit me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu, do të jetë përgjegjës për procedurat e planifikimit të buxhetit, dhe të gjitha propozimet do të pranohen dhe adresohen në drejtori përkatëse për tu vendosur nëpër strategji. Pastaj projektet e propozuara nga pjesëmarrësit do të financohen dhe renditen sipas përparësisë dhe rëndësisë.

Po ashtu gjatë diskutimit tha se propozimet nga dëgjimi i parë dhe i dytë buxhetor janë pranuar dhe listuar,

Dhe krahas kësaj planifikohen edhe një dëgjime buxhetore si :

- 15.09.2023 -----KPF,

Mirëpo në rast se ka iniciativa dhe kërkesa për mbajtje edhe të takimeve tjera shtesë gjithsesi do i fusim në agjendën e planifikimit dhe mbajtjes së rregullt.

Ajo ri theksoi se të gjitha projekt propozimet pranohen nga anëtarët e GP, listohen dhe adresohen tutje.

Gjithashtu të gjitha informatat lidhur me planifikim buxheti janë publike dhe mund ti gjeni në web faqen e komunës së Junikut.

Znj Vjollca Qestaj gjatë fjalës së saj tha se janë mbajt edhe dy takime si:

- Me qytetarë
- Me gratë e Junikut

Me kaq e mbylli prezantimin e saj znj, znj. Vjollca Qestaj, e cila më pastaj fjalën e kaloi tek pjesëmarrësit për propozime.

Nga të pranishmit fjalën e mori z. Sadri Krasniqi– anëtarë i kuvendit të komunës së Junikut i cili kërkoi:

- Rregullimi i kanalit të ujitjes Luçe -Shafrane dhe funksionalizimi i tij pasi që pjesërisht është i ndërtuar,
- Ndërtimi i kanalizimit në l. Krasniq konkretisht te Zem-Zem deri te Xheladin Abazi

- **Shpejtim Gacaferi:** Ndërtimi i rrethojës mbrojtëse të Mulliri i Nimon Tofaj (për shkaqe sigurie),
- Rekonstruimi i rrugës të Qazim Jaha (Gacafer),
- Të realizohet ndriçimi publik në lagjen Bramatok,
- Ndërtimi i murit mbrojtës me kanal Drenazhimi dhe rrethojë të terrenet sportive – buzë lumit Erenik,
- Rikonstruimi i urave për këmbësorë mbi lumin Erenik,
- **Saranda Isufaj:** investimet të orientohen më shumë kah tatimpaguesit më të rregullt të tatimit në pronë,

Znj. Vjollca Qestaj mori fjalën përmbysllëse pasi nuk pati propozime tjera duke falënderuar të pranishmit, për pjesëmarrje dhe sensibilizimin e qytetarëve që të jenë më aktivë.

Për fund tha: inkurajoheni të merrni pjesë në dëgjime publike me qëllim të propozimit dhe realizimit të projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u takofshim në dëgjimet e radhës.

Në këtë dëgjim publik ishin gjithsejtë 10 pjesëmarrës ku 4 nga totali i pjesëmarrësve ishin të gjinisë femërore.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Datë: 15.08.2023

DËGJIMI PUBLIK PËR BUXHETIN 2024-2026 ME QYTETARËT E KOMUNËS SË JUNIKUT

Numri	Emri dhe Mbiemri	Komuna	Nr. i telefonit	Email-i	Nënshkrimi
1					
2	FERDOWE TOFAJ	K. Junik		ferdowetofaj@rks-gov.net	Tofaj
3	SUNDIM KRASNICAJ	K. Junik	044-559-292	sundimkrasnjaj@rks-gov.net	Krasnjaj
4	FLODANT PERSH	K. JUNIK	044-760-276	florantpersh@rks-gov.net	Persh
5	VJOLCA QESTAJ	K. JUNIK	046-106-286	vjolcaqestaj@rks-gov.net	Qestaj
6	SARANDA ISUFATJ	K. JUNIK	045 379-004	saradz025@rks-gov.net	Isufatj
7	SADRI KRASNICAJ	K. JUNIK	045 691-360	krasnjajisadri67@gmail.com	Krasnjaj
8	SHPEJTIM GACAFERI	K.K	0441270-747	gacajerishpejtim@gmail.com	Gacajeri
9	DEME URAJ	K. JUNIK	044 179 313	deme.uraaj@integrov.com	Uraj
10					
11					